LIGJ
Nr.10 231, datë 11.2.2010

PËR RATIFIKIMIN E STATUTIT TË AGJENCISË NDËRKOMBËTARE TË ENERGJISË SË RINOVUESHME (IRENA)

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet statuti i Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë së Rinovueshme (IRENA), sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6439, datë 2.3.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

KONFERENCË MBI NGRITJEN

E AGJENCISË NDËRKOMBËTARE TË ENERGJISË SË RINOVUESHME
Statuti i IRENA-s, i nënshkruar në Bon

E hënë, 26 janar 2009 IRENA/CF/Statuti
Bon, Qendra e Konferencës Botërore

STATUT
I AGJENCISË NDËRKOMBËTARE TË ENERGJISË SË RINOVUESHME (IRENA)

Palët në këtë statut,

me dëshirën për të nxitur zbatimin dhe përdorimin e gjerë dhe intensiv të energjisë së rinovueshme me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm;

të frymëzuar nga besimi i tyre i thellë në mundësinë e gjerë të ofruar nga energjia e rinovueshme për të trajtuar dhe gradualisht zgjidhur problemet e sigurisë së energjisë dhe çmimet e paqëndrueshme të energjisë;

të bindur për rolin e madh që energjia e rinovueshme mund të luajë në uljen e përqendrimeve të gazrave serrë në atmosferë, duke kontribuar në këtë mënyrë në stabilizimin e sistemit klimaterik dhe duke mundësuar një kalim të qëndrueshëm, të sigurt dhe të lehtë në një ekonomi me karbon të ulët;

me dëshirën për të forcuar ndikimin pozitiv që teknologjitë e energjisë së rinovueshme kanë për stimulimin e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm dhe krijimin e vendeve të punës;

të motivuar nga potenciali i madh i energjisë së rinovueshme në mundësimin e pa-centralizuar të energjisë, veçanërisht në vendet në zhvillim dhe mundësimin e energjisë për rajonet dhe ishujt e largët;

të shqetësuar për ndikimet serioze negative që përdorimi i karburanteve fosile dhe përdorimi

jo i efektshëm i biomasës tradicionale mund të kenë mbi shëndetin;

të bindur që energjia e rinovueshme, e kombinuar me efikasitetin e shtuar të energjisë, mund të mbulojë gjithnjë e më shumë rritjen e menjëhershme të parashikuar në nevojat për energji në dekadat në vazhdim;

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Themelimi i agjencisë

A. Palët në këtë statut themelojnë Agjencinë Ndërkombëtare për Energjinë e Rinovueshme (këtu quhet "Agjencia") në pajtim me termat dhe kushtet e mëposhtme.

B. Agjencia bazohet në parimin e barazisë së të gjithë anëtarëve të saj dhe u kushton respektin e duhur të drejtave dhe kompetencave sovrane të anëtarëve në ushtrimin e aktiviteteve të saj.

Neni 2
Objektivat

Agjencia nxit zbatimin e gjerë dhe intensiv, si dhe përdorimin e qëndrueshëm të të gjitha formave të energjisë së rinovueshme, duke marrë parasysh:

a) prioritetet dhe përfitimet kombëtare dhe të brendshme që rrjedhin nga një trajtim i kombinuar i masave për energjinë e rinovueshme dhe efektshmërinë e energjisë, dhe

b) kontributin e energjisë së rinovueshme në ruajtjen e ambientit, nëpërmjet kufizimit të presionit mbi burimet natyrore dhe uljes së shpyllëzimit, veçanërisht shpyllëzimit tropikal, humbjes së biodiversitetit dhe dezertifikimit; për mbrojtjen e klimës; për rritjen ekonomike dhe kohezionin social duke përfshirë zbutjen e varfërisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm; mundësimin dhe garantimin e furnizimit me energji elektrike; zhvillimin rajonal dhe përgjegjësinë ndërmjet brezave.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë statut termi "energji e rinovueshme" do të thotë të gjitha format e energjisë që prodhohen nga burimet e energjisë së rinovueshme në një mënyrë të qëndrueshme, që përfshin, ndër të tjera:

1. bioenergjinë;
2. energjinë gjeotermike;
3. energjinë ujore;
4. energjinë oqeanike, duke përfshirë ndër të tjera, energjinë e baticës, valës dhe termale oqeanike;
5. energjinë solare; dhe
6. energjinë e erës.

Neni 4
Aktivitetet

A. Si qendër ekselence për teknologjinë e energjisë së rinovueshme dhe duke vepruar si ndihmuese dhe katalizatore, duke dhënë eksperiencë për aplikime dhe politika praktike, duke ofruar mbështetje për të gjitha çështjet në lidhje me energjinë e rinovueshme dhe duke ndihmuar vendet të përfitojnë nga zhvillimi efikas dhe transferimi i njohurive dhe teknologjisë, Agjencia kryen aktivitetet e mëposhtme:

1. Veçanërisht në përfitim të anëtarëve të saj, Agjencia:

a) Analizon, monitoron dhe, pa detyruar politikat e anëtarëve të saj, sistemon praktikat e

tashme të energjisë së rinovueshme, duke përfshirë instrumentet e politikave, shtysat, mekanizmat e investimit, praktikat më të mira, teknologjitë e disponueshme, sistemet dhe pajisjet e integruara dhe faktorët e suksesit dhe dështimit;

b) Fillon diskutime dhe siguron ndërveprimin me organizata dhe rrjete të tjera qeveritare dhe joqeveritare në këtë fushë dhe fusha të tjera përkatëse;

c) U jep anëtarëve këshilla përkatëse mbi politikat dhe asistencë me kërkesë të tyre, duke marrë parasysh nevojat e tyre përkatëse dhe stimulon diskutimet ndërkombëtare për politikën e energjisë së rinovueshme dhe kushtet e saj kuadër;

d) Përmirëson njohuritë përkatëse dhe transferimin e teknologjisë dhe nxit zhvillimin e kapaciteteve dhe kompetencave lokale te shtetet anëtare duke përfshirë ndërlidhjet e nevojshme;

e) Ofron ndërtim kapacitetesh, duke përfshirë trajnimin dhe edukimin e anëtarëve të saj;

f) U jep anëtarëve të saj, me kërkesë të tyre, këshilla mbi financimin për energjinë e rinovueshme dhe mbështet zbatimin e mekanizmave përkatës;

g) Stimulon dhe inkurajon kërkimin, duke përfshirë çështjet social-ekonomike dhe nxit rrjetet e kërkimit, kërkimin e përbashkët, zhvillimin dhe zbatimin e teknologjive; dhe

h) Jep informacion në lidhje me zhvillimin dhe zbatimin e standardeve teknike kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me energjinë e rinovueshme, bazuar në një mirëkuptim të shëndoshë nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në forumet përkatëse.

2. Për më tepër, Agjencia shpërndan informacion dhe rrit ndërgjegjësimin publik mbi përfitimet dhe potencialin e ofruar nga energjia e rinovueshme.

B. Gjatë kryerjes së aktiviteteve të saj, Agjencia:

1. Vepron në pajtim me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara për nxitjen e paqes dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, dhe në pajtim me politikat e Kombeve të Bashkuara që nxisin zhvillimin e qëndrueshëm;

2. I ofron burimet e saj në mënyrë të tillë që të sigurojë përdorimin efikas me qëllim trajtimin e përshtatshëm të të gjithë objektivave të saj dhe i kryen aktivitetet e saj për të arritur përfitimin më të madh të mundshëm për anëtarët e saj dhe në të gjitha zonat në botë, duke pasur parasysh nevojat e veçanta të vendeve në zhvillim dhe rajoneve dhe ishujve të largët;

3. Bashkëpunon ngushtë dhe përpiqet për vendosjen e raporteve me përfitim të dyanshëm me institucionet dhe organizatat ekzistuese, me qëllim mënjanimin e dublikimit të panevojshëm të punës dhe për t'u mbështetur dhe përdorur me efiçencë dhe efikasitet burimet dhe aktivitetet në vazhdim të qeverive, organizatave të tjera dhe agjencive, që synojnë nxitjen e energjisë së rinovueshme.

C. Agjencia:

1. u paraqit anëtarëve të saj raport vjetor mbi aktivitetin e saj;

2. informon anëtarët në lidhje me këshillat e saj mbi politikat, pasi të jenë dhënë; dhe

3. informon anëtarët në lidhje me konsultimin dhe bashkëpunimin dhe punën e organizatave ekzistuese që punojnë në këtë fushë.

Neni 5

Programet e punës dhe projektet

A. Agjencia i zbaton aktivitetet e saj mbi bazën e programeve vjetore të punës, të përgatitura nga sekretariati, të shqyrtuara nga këshilli dhe miratuar nga asambleja.

B. Agjencia, përveç programit të saj të punës, pas konsultimeve me anëtarët dhe, në rastin e mosmarrëveshjes, pas aprovimit nga asambleja, mund të zbatojë projekte të filluara dhe financuara nga anëtarët duke iu nënshtruar disponibilitetit të burimeve jofinanciare të Agjencisë.

Neni 6

Anëtarësimi

A. Anëtarësimi është i hapur për ato shtete që janë anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe organizatat rajonale ndërqeveritare të integrimit ekonomik që kanë vullnetin dhe aftësinë për të vepruar në pajtim me objektivat dhe aktivitetet e parashikuara në statut. Për të qenë i pranueshëm për

anëtarësim në Agjenci, një organizatë rajonale ndërqeveritare e integrimit ekonomik duhet të përbëhet nga shtete sovrane, ku të paktën një prej të cilëve është anëtar i Agjencisë, dhe të cilit shtetet anëtare ia kanë transferuar kompetencën në të paktën një prej çështjeve brenda objektit të aktivitetit të Agjencisë.

B. Këto shtete dhe organizatat rajonale ndërqeveritare të integrimit ekonomik bëhen:

1. Anëtare themeluese të Agjencisë, nëse e kanë nënshkruar këtë statut dhe kanë depozituar instrumentin e ratifikimit.

2. Anëtare të tjera të Agjencisë duke depozituar një instrument aderimi, pasi aplikimi për anëtarësim është aprovuar. Anëtarësimi konsiderohet i aprovuar, nëse nuk është shprehur asnjë kundërshtim brenda tre muajve, pasi aplikimi t'u jetë dërguar anëtarëve. Në rastin e mosmarrëveshjes, vendimi për aplikimin merret nga asambleja, në pajtim me nenin 9 paragrafi H numri 1.

C. Në rastin e një organizate rajonale, ndërqeveritare të integrimit ekonomik, organizata dhe shtetet e saj anëtare vendosin për përgjegjësitë e tyre përkatëse për përmbushjen e detyrimeve, sipas këtij statuti. Organizata dhe shtetet e saj anëtare nuk kanë të drejtë të ushtrojnë të drejta, duke përfshirë të drejtat e votës, sipas statutit njëkohësisht. Në instrumentet e ratifikimit ose aderimit, organizatat e përmendura më sipër deklarojnë shtrirjen e kompetencave të tyre në lidhje me çështjet e rregulluara nga ky statut. Këto organizata informojnë qeverinë depozituese për çdo modifikim përkatës dhe shtrirjen e kompetencave të tyre. Në rastin e votimit për çështjet brenda kompetencës së tyre, organizatat rajonale ndërqeveritare të integrimit ekonomik votojnë me numrin e votave të barabartë me numrin e votave që u jepen shteteve të tyre anëtare që janë gjithashtu anëtare të Agjencisë.

Neni 7
Vëzhguesit

A. Statusi i vëzhguesit mund t'u jepet nga asambleja:

1. Organizatave ndërqeveritare dhe joqeveritare, që veprojnë në fushën e energjisë së rinovueshme;

2. Nënshkruesve që nuk e kanë ratifikuar statutin; dhe

3. Aplikuesve për anëtarësim, aplikimi për anëtarësim i të cilëve është pranuar në pajtim me nenin 6, paragrafi B, numri 2.

B. Vëzhguesit mund të marrin pjesë pa të drejtë vote në sesionet publike të asamblesë dhe organeve në varësi të saj.

Neni 8
Organet

A. Themelohen si organe kryesore të Agjencisë:

1. Asambleja;

2. Këshilli;

3. Sekretariati.

B. Asambleja dhe këshilli, në pajtim me aprovimin e asamblesë, mund të themelojë organe të tilla varësie që ajo e sheh të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të saj në pajtim me statutin.

Neni 9
Asambleja

A. 1. Asambleja është organi më i lartë i Agjencisë.

2. Asambleja mund të diskutojë çdo çështje brenda objektit të këtij statuti ose në lidhje me kompetencat dhe funksionet e çdo organi të parashikuara në këtë statut.

3. Për çdo çështje të tillë, asambleja mund të:

a) marrë vendime dhe bëjë rekomandime për çdo organ të tillë; dhe

b) bëjë rekomandime për anëtarët e Agjencisë, me kërkesë të tyre.

4. Për më tepër, asambleja ka autoritetin të propozojë çështje për shqyrtim nga këshilli dhe të kërkojë nga këshilli dhe sekretariati raporte mbi çdo çështje në lidhje me funksionimin e Agjencisë.

B. Asambleja përbëhet nga të gjithë anëtarët e Agjencisë. Asambleja takohet në sesione periodike që mbahen çdo vit, përveç kur ajo vendos ndryshe.

C. Asambleja përfshin një përfaqësues nga secili anëtar. Përfaqësuesit mund të shoqërohen nga zëvendës ose këshilltarë. Shpenzimet për pjesëmarrjen e delegacionit mbulohen nga anëtari përkatës.

D. Sesionet e asamblesë zhvillohen në selinë e Agjencisë, përveç kur asambleja vendos ndryshe.

E. Në fillim të çdo sesioni periodik, asambleja zgjedh një president dhe ata zyrtarë të tjerë që kërkohen, duke pasur parasysh një përfaqësim të drejtë gjeografik. Ata qëndrojnë në detyrë derisa të zgjidhet presidenti i ri ose zyrtarë të tjerë në sesionin tjetër të radhës. Asambleja miraton rregullat e saj procedurale në pajtim me këtë statut.

F. Në pajtim me nenin 6, paragrafin C, secili anëtar i Agjencisë ka një votë në asamble. Asambleja i merr vendimet për çështjet procedurale me shumicë të thjeshtë që janë të pranishëm dhe votojnë. Vendimet mbi çështjet lëndore merren me konsensusin e anëtarëve të pranishëm. Nëse nuk arrihet konsensus, konsensusi konsiderohet i arritur, nëse nuk kundërshtojnë më shumë se 2 anëtarë, përveç kur statuti parashikon ndryshe. Kur ngrihet pyetja nëse çështja në diskutim është e natyrës lëndore apo jo, kjo trajtohet si çështje lëndore, përveç kur asambleja vendos ndryshe me konsensusin e anëtarëve të pranishëm, që, nëse nuk arrihet konsensusi, konsiderohet të jetë arritur nëse nuk kundërshtojnë më shumë se dy anëtarë. Një shumicë e anëtarëve të Agjencisë përbën kuorumin e asamblesë.

G. Asambleja, me konsensusin e anëtarëve të pranishëm:

1. zgjedh anëtarët e këshillit;

2. miraton në sesionet e saj periodike buxhetin dhe programin e punës së Agjencisë, të paraqitur nga këshilli, dhe ka autoritetin të vendosë për ndryshimet në buxhet dhe programin e punës së Agjencisë;

3. merr vendime në lidhje me mbikëqyrjen e politikave financiare të Agjencisë, rregullave financiare dhe çështjeve të tjera financiare dhe zgjedh auditin;

4. miraton ndryshimet në këtë statut;

5. vendos mbi themelimin e organeve të varësisë dhe aprovon termat e referencës së tyre;

6. vendos mbi lejen për të votuar në pajtim me nenin 17 paragrafi A.

H. Asambleja me konsensusin e anëtarëve të pranishëm, ku, nëse nuk mund të arrihet konsensus, ai konsiderohet i arritur nëse nuk kundërshtohet nga më shumë se 2 anëtarë:

1. vendos, sipas rastit, mbi aplikimet për anëtarësim;

2. aprovon rregullat procedurale të asamblesë dhe të këshillit, që paraqiten nga këta të fundit;

3. miraton raportin vjetor, si dhe raporte të tjera;

4. aprovon lidhjen e marrëveshjeve për çdo çështje brenda objektit të këtij statuti;

5. vendos në rastin e mosmarrëveshjeve ndërmjet anëtarëve të saj mbi projekte shtesë në pajtim me nenin 5 paragrafi B.

I. Asambleja cakton selinë e Agjencisë dhe drejtorin e përgjithshëm të sekretariatit (këtu quhet “Drejtor i Përgjithshëm”) me konsensusin e anëtarëve të pranishëm, ose, nëse nuk mund të arrihet konsensus, me shumicën e votave prej dy të tretat e anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë.

J. Asambleja shqyrton dhe aprovon, sipas rastit, në sesionin e parë çdo vendim, projekt-marrëveshje, dispozitë dhe udhëzim të zhvilluar nga komisioni përgatitor, në pajtim me procedurat e votimit për çështjen përkatëse që parashikohen në nenin 9 paragrafët F deri I.

Neni 10

Këshilli

A. Këshilli përbëhet nga të paktën 11, por jo më shumë se 21 përfaqësues të anëtarëve të Agjencisë, të zgjedhur nga asambleja. Numri konkret i përfaqësuesve ndërmjet 11 dhe 21 përputhet

me ekuivalentin e rrumbullakosur të një të tretës së anëtarëve të Agjencisë, që llogaritet në bazë të numrit të anëtarëve të Agjencisë në fillim të zgjedhjes përkatëse të anëtarëve të këshillit. Anëtarët e këshillit zgjidhen me bazë rotacioni sipas parashikimit në rregullat e procedurës së asamblesë, me qëllim sigurimin e pjesëmarrjes së efektshme të vendeve në zhvillim dhe të zhvilluara dhe arritjen e një shpërndarjeje të drejtë dhe të barabartë gjeografike dhe efektiviteti në punën e këshillit. Anëtarët e këshillit zgjidhen për një afat prej dy vjetësh.

B. Këshilli mblidhet dy herë në vit dhe mbledhjet e tij zhvillohen në selinë e Agjencisë, përveç kur këshilli vendos ndryshe.

C. Këshilli, në fillim të çdo mbledhjeje dhe me efekt deri në mbledhjen tjetër, zgjedh një kryetar dhe ata zyrtarë të tjerë nga anëtarët e vet që mund të jenë të nevojshëm. Ai ka të drejtën e përpilimit të rregullave procedurale. Këto rregulla procedurale duhet të paraqiten në asamble për aprovim.

D. Çdo anëtar këshilli ka një votë. Këshilli i merr vendimet për çështjet procedurale me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të tij. Vendimet mbi çështjet lëndore merren me shumicën e dy të tretave të anëtarëve të tij. Kur ngrihet pyetja nëse çështja në diskutim është e natyrës lëndore apo jo, kjo trajtohet si çështje lëndore, përveç kur këshilli vendos ndryshe me shumicën e dy të tretave të anëtarëve të tij.

E. Këshilli është përgjegjës dhe raporton në asamble. Këshilli ushtron kompetencat dhe funksionet e besuara atij sipas këtij statuti, si dhe ato funksione që i delegohen atij nga asambleja. Për ta bërë këtë, ai vepron në pajtim me vendimet dhe duke marrë parasysh rekomandimet e asamblesë dhe siguron zbatimin e tyre të përshtatshëm dhe të vazhdueshëm.

F. Këshilli:

1. lehtëson konsultimet dhe bashkëpunimin ndërmjet anëtarëve;

2. shqyrton dhe paraqet në asamble projektprogramin e punës dhe projektbuxhetin e Agjencisë;

3. aprovon masat për sesionet e asamblesë duke përfshirë përgatitjen e projektaxhendës;

4. shqyrton dhe paraqet në asamble projektraportin vjetor, në lidhje me aktivitetet e Agjencisë dhe raporte të tjera që përgatiten nga sekretariati, sipas nenit 11 paragrafi E numri 3 i këtij statuti;

5. përgatit çdo raport tjetër vjetor që mund të kërkojë asambleja;

6. lidh marrëveshje ose përgatit masa me shtete, organizata ndërkombëtare dhe agjenci ndërkombëtare në emër të Agjencisë, duke iu nënshtruar aprovimit paraprak të asamblesë;

7. realizon programin e punës të miratuar nga asambleja, me qëllim zbatimin e saj nga sekretariati dhe brenda kufijve të buxhetit të miratuar;

8. ka autoritetin t'i kalojë asamblesë çështje për shqyrtim, dhe

9. themelojë organe varësie, sipas rastit, në pajtim me nenin 8, paragrafi B, dhe të vendosë për termat e tyre të referencës dhe kohëzgjatjen.

Neni 11

Sekretariati

A. Sekretariati ndihmon asamblenë, këshillin dhe organet e tyre të varësisë në përmbushjen e funksioneve të tyre. Ai kryen funksione të tjera që i besohen atij sipas statutit, si dhe ato funksione që i delegohen atij nga asambleja ose këshilli.

B. Sekretariati përbëhet nga drejtori i përgjithshëm, që është drejtuesi i tij dhe përgjegjësi i administratës dhe personeli tjetër i nevojshëm. Drejtori i përgjithshëm emërohet nga asambleja me rekomandim të këshillit për një afat prej katër vjetësh, të rinovueshëm për një mandat tjetër, por jo pas kësaj.

C. Drejtori i përgjithshëm është përgjegjës kundrejt asamblesë dhe këshillit, ndërmjet të tjerash, për emërimin e personelit, si dhe organizimin dhe funksionimin e sekretariatit. Shqyrtimi i kujdesshëm i punësimit të personelit dhe i caktimit të kushteve të shërbimit është i domosdoshëm për të siguruar standardet më të larta të efikasitetit, kompetencës dhe integritetit. Duhet t'i kushtohet vëmendje e duhur rëndësisë së rekrutimit të personelit kryesisht nga shtetet anëtare dhe me një bazë gjeografike sa më të gjerë që të jetë e mundur, duke marrë veçanërisht parasysh përfaqësimin e përshtatshëm të vendeve në zhvillim dhe duke theksuar balancën e gjinisë. Në përgatitjen e buxhetit,

rekrutimi i propozuar drejtohet nga parimi që personeli të mbahet në nivelin minimal të nevojshëm për përmbushjen e përgjegjësive të sekretariatit.

D. Drejtori i përgjithshëm ose një përfaqësues i caktuar prej tij ose saj, merr pjesë, pa të drejtë vote, në të gjitha takimet e asamblesë dhe të këshillit.

E. Sekretariati:

1. përgatit dhe i paraqet këshillit projektprogramin e punës dhe projektbuxhetin e Agjencisë;

2. zbaton programin e punës së Agjencisë dhe vendimet e saj;

3. përgatit dhe i paraqet këshillit projektraportin vjetor, në lidhje me aktivitetet e Agjencisë dhe ato raporte të tjera që mund të kërkojë asambleja ose këshilli;

4. i jep asamblesë, këshillit dhe organeve të tyre të varësisë mbështetje administrative dhe teknike;

5. lehtëson komunikimin ndërmjet Agjencisë dhe anëtarëve të saj; dhe

6. qarkullon këshillimin mbi politikat, pasi t'u jetë dhënë anëtarëve të Agjencisë në pajtim me nenin 4 paragrafi C numri 2 dhe përgatit dhe paraqet në asamble dhe këshill një raport mbi këshillimin e tij mbi politikat për secilin prej sesioneve të tyre. Raporti në këshill përfshin edhe këshillimin e planifikuar mbi politikat në zbatimin e programit vjetor të punës.

F. Për përmbushjen e detyrave të tyre, drejtori i përgjithshëm dhe anëtarët e tjerë të personelit nuk kërkojnë ose marrin udhëzime nga asnjë qeveri ose burim tjetër nga jashtë Agjencisë. Ata nuk kryejnë asnjë veprim që mund të ndikojnë në pozicionin e tyre si zyrtarë ndërkombëtarë të përgjegjshëm ndaj Agjencisë dhe këshillit. Çdo anëtar respekton vetëm karakterin ndërkombëtar të përgjegjësive të drejtorit të përgjithshëm dhe të anëtarëve të tjerë të personelit dhe nuk përpiqet të ndikojë në përmbushjen e përgjegjësive të tyre.

Neni 12

Buxheti

A. Buxheti i Agjencisë financohet nga:

1. kontributet e detyrueshme të anëtarëve të saj, që bazohen në shkallën e vlerësimeve të Kombeve të Bashkuara, që përcaktohen nga asambleja;

2. kontributet vullnetare; dhe

3. burime të tjera të mundshme

në pajtim me rregullat financiare të miratuara nga asambleja me konsensus, që parashikohen në nenin 9, paragrafi G, i këtij statuti. Rregullat financiare dhe buxheti sigurojnë një bazë të shëndoshë financiare të Agjencisë dhe sigurojnë zbatimin e efektshëm dhe efikas të aktiviteteve të Agjencisë, sipas përcaktimit në programin e punës. Kontributet e detyrueshme financojnë aktivitetet financiare thelbësore dhe shpenzimet administrative.

B. Projektbuxheti i Agjencisë përgatitet nga sekretariati dhe i paraqitet këshillit për shqyrtim. Këshilli ia paraqet atë asamblesë me një rekomandim për aprovim ose ia kthen atë sekretariatit për rishikim dhe riparaqitje.

C. Asambleja cakton një audit të jashtëm që qëndron në detyrë për një periudhë prej katër vitesh dhe që është i përshtatshëm për rizgjedhje. Auditi i parë qëndron në detyrë për një periudhë prej dy vitesh. Auditi shqyrton llogaritë e Agjencisë dhe bën ato vërejtje dhe rekomandime që mendohen të nevojshme, në lidhje me efikasitetin e menaxhimit dhe kontrolleve të brendshme financiare.

Neni 13

Zotësia juridike, privilegjet dhe imunitetet

A. Agjencia ka zotësi juridike ndërkombëtare. Në territorin e secilit anëtar dhe në pajtim me legjislacionin e tij të brendshëm, ai gëzon atë zotësi juridike të brendshme që mund të jetë i nevojshëm për ushtrimin e funksioneve dhe përmbushjen e qëllimeve të saj.

B. Anëtarët vendosin privilegjet dhe imunitetet në një marrëveshje të veçantë.

Neni 14

Marrëdhëniet me organizatat e tjera

Pas aprovimit të asamblesë, këshilli autorizohet të lidhë marrëveshje në emër të Agjencisë duke vendosur marrëdhënie të përshtatshme me Kombet e Bashkuara dhe çdo organizatë tjetër ndërkombëtare, puna e së cilës lidhet me atë të Agjencisë. Dispozitat e këtij statuti nuk cenojnë të drejtat dhe detyrimet e asnjë anëtari që rrjedhin nga një traktat ekzistues ndërkombëtar.

Neni 15
Ndryshimet dhe tërheqja, rishikimi

A. Ndryshimet në këtë statut mund të propozohen nga çdo anëtar. Kopje të vërtetuara të tekstit të çdo ndryshimi të propozuar përgatiten nga drejtori i përgjithshëm dhe u komunikohen të gjithë anëtarëve të paktën nëntëdhjetë ditë para shqyrtimit nga asambleja.

B. Ndryshimet hyjnë në fuqi për të gjithë anëtarët:

1. Kur aprovohen nga asambleja pas shqyrtimit të vërejtjeve të bëra nga këshilli për çdo ndryshim të propozuar; dhe

2. Pasi të gjithë anëtarët të kenë dhënë pëlqimin për t'iu nënshtruar ndryshimit, në pajtim me proceset e tyre përkatëse kushtetuese. Anëtarët shprehin pëlqimin e tyre përkatës duke depozituar një instrument përkatës te depozituesi i përmendur në nenin 20, paragrafi A.

C. Në çdo kohë pas pesë vitesh nga data kur hyn në fuqi ky statut në pajtim me paragrafin D të nenit 19, një anëtar mund të tërhiqet nga Agjencia me anë të njoftimit me shkrim për këtë qëllim, të paraqitur depozituesit të përmendur në nenin 20, paragrafi A, që njofton menjëherë këshillin dhe të gjithë anëtarët.

D. Kjo tërheqje hyn në fuqi në fund të vitit në të cilin shprehet. Tërheqja e një anëtari nga Agjencia nuk cenon detyrimet e tij kontraktuale që janë marrë përsipër në pajtim me nenin 5, paragrafi B ose detyrimet e tij financiare për vitin në të cilin ai tërhiqet.

Neni 16
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

A. Anëtarët zgjidhin çdo mosmarrëveshje ndërmjet tyre, në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij statuti me mjete paqësore në pajtim me nenin 2 paragrafi 3 i Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe, për këtë qëllim, kërkojnë një zgjidhje me mjetet e treguara në nenin 33, paragrafi 1 i Kartës së Kombeve të Bashkuara.

B. Këshilli mund të kontribuojë për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje me çdo mjet që ai e konsideron të përshtatshëm, duke përfshirë ofrimin e shërbimeve të tij, duke u bërë thirrje anëtarëve në mosmarrëveshje të fillojnë procesin e zgjidhjes sipas zgjedhjes së tyre dhe duke rekomanduar një afat kohor për çdo procedurë të rënë dakord.

Neni 17
Pezullimi i përkohshëm i të drejtave

A. Çdo anëtar i Agjencisë, që është në vonesë në dhënien e kontributeve financiare Agjencisë, nuk ka të drejtë vote, nëse vonesat arrijnë ose tejkalojnë shumën e kontributeve të tij për dy vitet e mëparshme. Megjithatë, asambleja mund ta lejojë këtë anëtar të votojë, nëse është e bindur që mospagesa është për shkak të rrethanave jashtë kontrollit të anëtarit.

B. Një anëtar që ka shkelur vazhdimisht dispozitat e këtij statuti ose të një marrëveshjeje të lidhur prej tij në pajtim më këtë statut mund të pezullohet nga ushtrimi i privilegjeve dhe të drejtave të anëtarësisë nga asambleja duke vepruar me shumicën prej dy të tretat e anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë me rekomandim të këshillit.

Neni 18
Selia e Agjencisë

Selia e Agjencisë përcaktohet nga asambleja në sesionin e saj të parë.

Neni 19

Nënshkrimi, ratifikimi, hyrja në fuqi dhe aderimi

A. Ky statut është i hapur për nënshkrim në Konferencën Themeluese nga të gjitha shtetet që janë anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe organizatat rajonale ndërqeveritare të integrimit ekonomik, siç përcaktohet nga neni 6 paragrafi A. Ajo mbetet e hapur për nënshkrim deri në datën që hyn në fuqi ky statut.

B. Për shtetet dhe organizatat rajonale ndërqeveritare të integrimit ekonomik sipas përcaktimit në nenin 6 paragrafi A që nuk e kanë nënshkruar këtë statut, ky statut është i hapur për aderim pasi anëtarësimi i tyre të jetë aprovuar nga asambleja në pajtim me nenin 6 paragrafi B numri 2.

C. Pëlqimi për t'iu nënshtruar këtij statuti shprehet nëpërmjet depozitimit të një instrumenti të ratifikimit ose aderimit te depozituesi. Ratifikimi ose aderimi në këtë statut realizohet nga shtetet në pajtim me proceset e tyre përkatëse kushtetuese.

D. Ky statut hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pa datës së depozitimit të instrumentit të njëzet e pestë të ratifikimit.

E. Për shtetet ose organizatat rajonale ndërqeveritare të integrimit ekonomik që kanë depozituar një instrument ratifikimi ose aderimi pas hyrjes në fuqi të statutit, ky statut hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit përkatës.

F. Asnjë rezervë nuk mund t'u bëhet dispozitave që gjenden në këtë statut.

Neni 20

Depozituesi, regjistrimi, teksti autentik

A. Qeveria e Republikës Federale Gjermane caktohet si depozituese e këtij statuti dhe çdo instrumenti të ratifikimit ose aderimit.

B. Ky statut regjistrohet nga qeveria depozituese në pajtim me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

C. Ky statut, i bërë në gjuhën angleze, depozitohet në arkivat e qeverisë depozituese.

D. Kopje të vërtetuara rregullisht të këtij statuti u transmetohen nga qeveria depozituese qeverive të shteteve dhe organeve ekzekutive të organizatave rajonale ndërqeveritare të integrimit ekonomik që e kanë nënshkruar ose janë aprovuar për anëtarësim sipas nenit 6 paragrafi B numri 2.

E. Qeveria depozituese informon menjëherë të gjithë nënshkruesit e këtij statuti për datën e çdo depozitimi të instrumentit të ratifikimit dhe datës së hyrjes në fuqi të statutit.

F. Qeveria depozituese informon menjëherë të gjithë nënshkruesit dhe anëtarët për datat në të cilat shtetet ose organizatat rajonale ndërqeveritare të integrimit ekonomik bëhen më vonë anëtare të saj.

G. Qeveria depozituese dërgon menjëherë kërkesat për anëtarësim tek të gjithë anëtarët e Agjencisë për shqyrtim sipas nenit 6 paragrafi B, numri 2.

Në dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, duke qenë rregullisht të autorizuar, e kanë nënshkruar këtë statut.

Bërë në Bon, më 26 janar 2009, në një kopje origjinale të vetme, në gjuhën angleze.